



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 122, Datë 04.06.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A (OSHEE SH.A), MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 112, DATË 08.07.2016 E VLEFSHME DERI MË DATË 08.07.2021 TEK SHOQËRIA "FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL" SH.A (FSHU SH.A)

Në mbështetje të neneve 16; 19, gërma “d”; 37, pika 2, gërma “c” dhe nenit 44, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016 i ndryshuar, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “c”; 5, pika 1, gërma “c”; 10, pika 3; 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 si dhe nenit 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), miratuar me vendimin e bordit të ERE – s nr. 112, datë 08.07.2016 tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a), e vlefshme deri me datë 08.07.2021,

Konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a me shkresën me nr. 7818 Prot., datë 27.04.2018, ka përcjellë dokumentacionin për transferimin e licencave/licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a dhe me shkresën nr. 2 Prot., datë 27.04.2018 shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a) ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a).

- Shoqëria OSHEE sh.a është licencuar pranë ERE-s në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 08.07.2016.
- Me shkresën nr.1090/1 Prot., datë 06.04.2018, OSHEE sh.a ka bërë me dije themelimin e shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a), në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për Sektorin e Enrgjisë Elektrike", i ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe Urdhërit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 Prot., datë 12.02.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a në cilësinë e Aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.03.2018.
- Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për Procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 17, pika 2, gërma "a", formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gërmat "a", "b" "c") plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, gërma "b", dokumentat juridike, administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2, gërmat "a", "b", "c", "d", "e") plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 17, pika 2, gërma "c", dokumentat financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 gërmat "b", "c", "d"), plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Neni 17, pika 2, gërma "d": (çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.) Diagrama e sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistues dhe ata të perspektives – Subjekti nuk deklaron që ka modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike ose reflektim të ndryshimeve.
 - Neni 17, pika 4, gërma "a". (Formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1) plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Neni 17, pika 4, gërma "b": (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkeses për transferimin e licencës), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3 gërma "a", (vërtetime që shoqëria nuk ka detyrime për tatim – taksa dhe ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore);
- Nenin 17, pika 4, gërma "c": (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licensuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës), do të njoftohet shoqëria që në bazë të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike* neni 11, pika 1, t'i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës së Furnizimit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 08.07.2016 e vlefshme deri me datë 08.07.2021, tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a),
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari

Petrit AHMETI